



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË

Nr.....Prot

Tiranë 18/11/2022

NJOFTIM

PËR SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, vendimin nr.643, datë 23.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurimit të hapur” si dhe vendimit nr 22, datë 16.11.2022 të Këshillit të Gjykatës, “Për shpalljen e disa vendeve vakante në organikën e Gjykatës së Lartë”, Gjykata e Lartë, shpall procedurën e “Lëvizjes paralele” dhe “Pranim në shërbimin civil gjyqësor” për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- **1 (një) pozicion, Specialist në Shërbimin e Protokoll-Arkivës, Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, kategoria III-b**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin si më sipër është:

Nëpunësi civil gjyqësor (specialist) në shërbimin e protokollit të Gjykatës mban, administron dhe shpërndan korrespondencën zyrtare të çdo lloji dhe garanton krijimin dhe ruajtjen e dokumentacionit gjyqësor si pjesë e dokumenteve historike –kombëtare me qëllim ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore gjyqësore si pjesë e trashëgimisë kombëtare. Specialisti në ushtrimin e detyrave të tij/saj udhëhiqet nga parimet e parashikuara në Ligjin për “Pushtetin Gjyqësor” dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën e informimit si dhe legjislacionin në fushën e arkivave në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse dhe Rregulloren e Gjykatës. Shërbimet e specialistit të protokoll- arkivës synojnë të garantojnë transparencën e mënyrës së funksionimit të Gjykatës duke garantuar në të njëjtën kohë edhe të drejtën për ruajtjen e të dhënave personale.

Nëpunësi civil gjyqësor pranë shërbimit të protokoll- arkivës, në Drejtorinë e Administrimit Gjyqësor ushtron në veçanti këto kompetenca:

- Mban protokollin e korrespondencës zyrtare, të zakonshme ose të klasifikuar, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe normative në fuqi në fushën e informimit publik, informacionit të klasifikuar dhe arkivit;
- Mban dhe administron librat e dorëzimit të shkresave të korrespondencës brenda Gjykatës së Lartë;
- Përcjell shkresat pa vonesë pas protokollimit, Kryetarit të Gjykatës apo Kancelarit;
- Kujdeset për hapjen, mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave arkivor, të cilat plotësohen në mënyrë manuale me shkrim të qartë, të pastër e të lexueshëm dhe/ose elektronike;
- Zbaton aktet ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me fondin arkivor dhe arkivat në Republikën e Shqipërisë;
- Lëshon kopje të vendimeve të fondit të arkivit të Gjykatës së Lartë, të cilat njësohen nga përgjegjësi i sektorit të administrimit gjyqësor;
- Plotëson, ruan, përgatit dhe jep për shfrytëzim dokumentet, ndjek zbatimin e dispozitave për punën me dokumentet, merr masat për evakuimin për raste fatkeqësish;
- Dorëzon, sipas rregullave të Arkivit Qendror të Shtetit dokumentet me afat ruajtjeje të përhershme;
- Kujdeset për asgjësimin e dokumenteve me afat ruajtjeje të përkohshme, sipas afateve, me komision, sipas ligjit.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e arkivit të shkresave që hyjnë e dalin në dhe nga Gjykata e Lartë;
- Plotëson, ruan, përgatit dhe jep për shfrytëzim dokumentet, ndjek zbatimin e dispozitave për punën me dokumentet, merr masat për evakuimin për raste fatkeqësish;

- Dorëzon, sipas rregullave të Arkivit Qendror të Shtetit dokumentet me afat ruajtjeje të përhershme;
- Të kujdeset për hapjen, mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave arkivor, të cilat plotësohen në mënyrë manuale me shkrim të qartë, të pastër e të lexueshëm dhe/ose elektronike;
- Kryen detyra të tjera që i caktohen nga Kancelari.

I. LËVIZJA PARALELE.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët për këtë procedure, janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë, të paktën, vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
- d- Të plotësojë kushtet e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kritere të veçanta :

Arsimi:

- Të jetë diplomuar në shkencat sociale në nivelin ‘Master Profesional’ ose të barasvlerëshëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë.

Përvoja: Të ketë kryer të paktën **5 (pesë)** vjet punë në fushën e protokollit zyrtar në administratën publike. Përvoja profesionale të jetë në kryerjen e veprimeve të regjistrimit të dokumenteve të Protokollit dhe Arkivës sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesa të tjera të veçanta për pozicionin e shpallur:

- Njohuri të mira praktike në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve aplikative.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nën ligjore në fushën e protokollit dhe arkivës gjyqësore.
- Aftësi analitike dhe krijuese për mbështetjen e zgjidhjeve të situatave komplekse.
- Aftësi vetëmotivuese për të punuar i pavaruar brenda afateve kohore të ngushta në një mjedis pune intensive.
- Aftësi vetëorganizuese, dhe aftësi krijuese për të dhënë sugjerime dhe propozime të dobishme për ecurinë e punës.
- Aftësi shumë të mira për të relatuar me shkrim dhe me gojë për punën e sektorit që mbulon.

- Cilësi të nevojshme për të punuar në grup.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në Gjykatën e Lartë në adresën: Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë, brenda datës **02 dhjetor 2022**, këto dokumente:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Jetëshkrimi CV (mund të hartohet në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun [http://dap.gov.al/vende -vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta))
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pashaportës.
- Fotokopje të diplomave.
- Fotokopje të listës së notave.(Bachelor, Master).
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
- Aktin e emërimit si nëpunës civil gjyqësor
- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore (vetëdeklarim).
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

I.3. VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT

Verifikimi paraprak, i përmbushjes së kushteve minimale për pozicionin e punës dhe kërkesave të veçanta në shpalljen për konkurrim, do të kryhet brenda datës **06.12.2022** dhe brenda datës **09.12.2022** do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim dhe listat e atyre që nuk i plotësojnë.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

Pikët totale për vlerësimin e dokumentacionit janë 70 (shtatëdhjetë) dhe ndahen si vijon:

- a) deri në 30 (tridhjetë) pikë për rezultatet e vlerësimit të punës,
- b) deri në 30 (tridhjetë) pikë për përvojën profesionale lidhur me pozicionin përkatës,
- c) deri në 10 (dhjetë) pikë për trajnimin e lidhur me fushën përkatëse.

I.4. INTERVISTA E STRUKTURUAR ME GOJË

Për datën dhe orën e intervistës së strukturuar me gojë, kandidatët fitues të fazës së parë, do të informohen nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë www.gjykataelarte.gov.al në rubrikën “*Marrëdhëniet me Publikun – Vende vakante*” si dhe në rrugë elektronike.

Pikët totale për vlerësimin e intervistës me gojë janë 30 (tridhjetë) pikë.

Përmbajtja e pyetjeve të intervistës me gojë lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat që nevojiten për pozicionin e punës, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës.

Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punës
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
- Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”

I.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Data e daljes së rezultateve do të jetë **16.12.2022**.

Në përfundim të daljes së rezultateve të vlerësimit të kandidatëve, njoftimi me emrat e nëpunësve fitues do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ-së www.klgj.al dhe në faqen web të gjykatës, www.gjykataelarte.gov.al

Njoftimi dhe komunikimi për kandidatët do të jetë nëpërmjet adresës së e-mail të kandidatit.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës së Lartë duke filluar nga data **13.12.2022** për pozicionin “Specialist” në Shërbimin e Protokoll- Arkivës, Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, në portalin “*Marrëdhëniet me publikun-Vende vakante*”.

Kriteret e përgjithshme si më poshtë:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo shërbimi civil gjyqësor, që nuk është shuar sipas ligjit.

Kriteret e veçanta janë si më sipër tek lëvizja paralele.

Rezultatet për verifikimin paraprak të kushteve minimale të procedurës pranimit në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datë **16.12.2022** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin në faqen zyrtare Gjykatës së Lartë dhe të Kljg-së.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten tek Kancelari i Gjykatës, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Nga data **16.12.2022**, Gjykata e Lartë dhe KLGJ do të shpallin në faqen zyrtare listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive, si dhe **datën, vendin dhe orën** e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten tek Kancelari i Gjykatës, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

Ligji për arkivën e shtetit dhe aktet nënligjore të tij;

Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;

Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Ligjin 119/2014 “Për të drejten e informimit”

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.

b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga përfundimi i testimit me shkrim, ftohen kandidatët për intervistë dhe kandidati për vendin e lirë përkatës zgjidhet, duke marrë parasysh kriteret sipas pikëzimit si vijon:

a) renditjen në listën e kandidatëve, sipas pikëve të vlerësimit me shkrim;

b) 25 pikë për karakteristikat e veçanta të kandidatit në bazë të intervistës së strukturuar me gojë,

c) 15 pikë për vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a – Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;

b – Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c – Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Data e daljes së rezultateve do të jetë **06.01.2023**. Pas arsyetimit dhe publikimit të vendimit për rezultatet e procedurës së emërimit nga Këshilli, ky vendim do t’u njoftohet të gjithë kandidatëve. Këshilli, pas marrjes së mendimit me shkrim nga kandidati fitues, shpall fituesin në faqen web të Gjykatës së Lartë www.gjykataelarte.gov.al dhe faqen zyrtare të KLGJ-së, www.klgj.al.

KËSHILLI I GJYKATËS
GJYKATA E LARTË
Rr. Ibrahim Rugova, Nr.10, 1001 Tiranë